

Europa League/ Kukësi - Torpedo 2-0

nga AlbaniaSoccer

E premte, 03 Korrik 2015 22:39



Kukësi ka arritur të fitojë takimin e turit të parë të UEFA Europa League, të luajtur në Stadiumin Kombëtar "Qemal Stafa" duke mundur me rezultatin e pastër 2-0 skuadrën Bjelloruse të Torpedos. Golat u shënuan nga Karioka dhe Pejic, nga një në çdo pjesë. Vlen të përmendet se Kukësi e dominoi takimin dhe pati kontroll të lojës në pjesën më të madhe. Vlen të përmendet paraqitja e mirë që bëjnë lojtarët e sapoardhur në skuadër nga Brazili. Me këtë fitore Kukësi ka bërë një përparesi të madhe që e ndihmon në kualifikimin për në turin e dytë të Europa League. Takimi i radhës do të luhen të Bjellorusi të enjten e ardhshme.